

VENDIM

Nr. 5 Date 15.04.2015

**PER MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NE STRUKTUREN E ADMINISTRATES
SE KESHILLIT TE QARKUT KUKES**

Keshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e tij të datës së mesipërme, pas propozimit të Kryetarit, bazuar në ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1/b, 8/1/c, 54/d, ligjin Nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjin Nr.152/2013 të miratuar me datë 30.05.2013 "Për Nepunesin Civil", ligjin Nr.10 257, datë 25.03.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8752, datë 26.01.2001 - Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për mbrojtjen e tokës" nëni 5, ligjin Nr.9244, datë 17.06.2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore" nëni 9/2, VKM Nr.80, datë 28.01.2005 "Për përberjen, menyrat e funksionimit, detyrat e përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore të Mbrojtjes së Tokës Bujqësore" kreu IV, pika 1, vendimin e Kryesise së KQK-se Nr.4, datë 15.04.2015 "Për miratimin e P/Akteve për mbledhjen e Keshillit të Qarkut Kukës" si dhe në shkresën e Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave Nr.1648/1 Prot. datë 05.03.2015,

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në strukturën e administratës së Keshillit të Qarkut Kukës si më poshtë vijon:

a. Ndryshimin e emertësës së 2 (dy) pozicioneve të punës të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, Programimit dhe Statistikave (TIPS):

Nr.	Emertimi i Funkcionit	Nr. Personelit	Arsimi
1.	Specialist për WEB dhe programimin	1	Ing. Programist
2.	Specialist për multimedian	1	Ing. Elektronike, Ing. Informatike

b. Ndryshimin e emertësës së 1 (një) pozicioni pune në Drejtorinë e Sherbimeve dhe Planifikimit Territorit (DSHPT) nga Inspektor i Mbrojtjes Tokës dhe Mjedisit, në :

Nr.	Emertimi i Funkcionit	Nr. Personelit	Arsimi
1.	Specialist për mjedisin dhe bujqësinë	1	Juridik, Ing.mjedisi, agronom,

c. Prane DAMT-se, të krijohet si sektor i veçantë Inspektoriati i Mbrojtjes Tokës (punonjes me kontratë të perkohshme), sipas strukturës së mëposhtme:

Nr.	Emertimi i Funkcionit	Nr. Personelit	Arsimi
-----	-----------------------	----------------	--------

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Keshillit te Qarkut, si dhe Drejtoria Juridike, Finances dhe MBNJ-se.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI
Ibsen ELEZI



Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari: B. Ngjeçi

U hartua ne 3 (tre) kopje origjinale:

1. Zyres se Arkivit